

NJOFTIM

MBI APLIKIMIN E APLIKUESIT “PALUSHI” SH.P.K., PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “GJALLICA” ME KAPACITET PRODHUES DERI NË 2 MW, NË PËRROIN E TËRSHANES, DEGË E PËRROIT TË BICAJT, DEGË E LUMIT DRIN I ZI, BASHKIA KUKËS, QARKU KUKËS

Në përputhje me Ligjin nr.43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, Aplikuesi “Palushi” sh.p.k., ka aplikuar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për miratimin e ndërtimit të hidrocentralit “Gjallica”, me kapacitet prodhues deri në 2 MW, në përroin e Tërshanes, degë e përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

- Shoqëria “PALUSHI” SH.P.K., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt të aktivitetit: Per zbatim.Kat. 1-Punime dheu, sistemime, tarracime, tarracime terrenesh, etj. Kat.3-Ndertime civile dhe ekonomike. Kat.4/a-Ndërtim rruge. Kat.V,VI. Kat.6/aNdërtim vepra arti të vogla deri në 6 m. Kat.8/b-Ndërtim ujësjellësa kanalizime. Ndërtim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditëse. Kat. 10/a-Rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash etj. Shfrytëzim miniere, Shfrytëzim gëlqeror, mineralesh. Ndërtime civile dhe ekonomike, industriale, turistike. Ndërtimin e rrjeteve inxhinierike. Projektim, zbatim, mirëmbajtje periodike, riparim dhe rehabilitim në fushën e automatizimit industrial në makineri, mjete, pajisje, sisteme të ndryshme elektrike, elektronike, mekanike si: Sisteme, impiante, linja të trajtimit të mbetjeve, sistemime, impiante, linja komandimi për HEC-e, centrale, nënstacione TN, TM, TV. Ndërtime dhe mirëmbajtje të rrugëve, autostradave, tunele, hidrocentrale, TEC, parqeve turistike, rikonstruksione dhe ndërtime të godinave civile, mbi 6 kate, punime nëntokësore, ndërtim, mirëmbajtje dhe operim aeroporte, porte, stacione hekurudhore, terminate pasagjeresh. Kryerja e shërbimit të grumbullimit, transportimit të mbetjeve urbane dhe inerteve. Prodhim dhe shitje energjie elektrike.

Një informacion më i detajuar lidhur me projektin mund të gjendet pranë Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

Objeksionet ose komentet lidhur me këtë aplikim mund të dërgohen në adresën e mëposhtme brenda 15 ditësh nga data e publikimit.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit

Blvd. Dëshmorët e Kombit, 1001

Tiranë